

Marenglen VERLI

ÇËSHTJA E KOSOVËS, UÇK DHE NDËRHJRJA E NATO-S*

Ndonëse me zanafillë më të hershme, *çështja e Kosovës, siç dihet, u shfaq e plotë në vitin 1913*, si një ndër pjesët e çështjes shqiptare, për shkak të vendimeve të Fuqive të Mëdha të marra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.¹ Ato vendime të marra *në interes të paqes evropiane*, që gjithsesi nuk u siguria, toleruan ekspansionin e qarqeve drejtuese monarkiste të Beogradit, dhe diktuan copëtimin e trevave shqiptare.² *Të gjithë treguesit përcaktues*, veçanërisht përbërja etnike dhe kompozimi shpirtëror i shumicës dërrmuese të popullsisë së Kosovës dhe shumë viseve të tjera që iu aneksuan Serbisë, *dëshmonin se ishte fjala për treva të mirëfillta shqiptare, që sakrifkoheshin arbitrarisht dhe padrejtësisht* të mbeteshin nën sundimin e huaj, në vend që të përfshiheshin natyrshëm në shtetin e vet kombëtar të porsakrijuar.³

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor “Kosova 15 vjet pavarësi – sfidat dhe shtetformimi”, organizuar në Prishtinë, më 15 shkurt 2023.

¹ Më 22 mars, 11 gusht dhe 17 dhjetor 1913 u vendos çështja e kufijve të Shqipërisë. Shih: *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare (1912-1918), (përmbledhje dokumentesh dhe vështrim historik)*, vëll. II, Tiranë, 1987. Shih edhe: *Arkivi i Institutit të Historisë*, Fondi i Vjenës etj.

² “Unë e di fare mirë, - deklaroi E. Grei më 12 gusht 1913 në Dhomën e Komuneve, - se kur gjithçka të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë vendore. *Qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha* dhe, në qoftë se vendimi i marrë e ka siguruar atë, ai ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes në Evropë”. Citimi sipas: *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë, 1984, 105.

³ Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 28 nëntor 1912 në Vlorë në një Kuvend Kombëtar dhe

Shqiptarët nuk ishin në gjendje të pengonin më 1913 krijimin e çështjes së Kosovës dhe as patën rast, fuqi e aleatë, ose mirëkuptim rajonal e ndërkombëtar, që ta korrigjonin apo ta zgjidhnin atë më vonë në mënyrë të drejtë, por vendimi i marrë krijoi një precedent të rrezikshëm për stabilitetin në rajon deri në ditët tona. Historia gati shekullore e konfliktit midis shqiptarëve të dëmtuar rënd dhe atyre që përfituan padrejtësisht për shkak të koniunkturave të kohës, është argument i pakundërshtueshëm për të shpjeguar situatën negative që u krijua, e cila u kushtoi shtrenjtë të gjithëve.

Për shqiptarët përgjithësisht dhe për elitën politike shqiptare kudo qoftë, brenda ose jashtë shtetit shqiptar, çështja e Kosovës nuk mund të shmangej. Ajo lindi kundër vullnetit të shqiptarëve, duke vënë nën sundimin e huaj gjysmën e tyre dhe prandaj sa kohë do të ekzistonte një shtet shqiptar, por edhe në Kosovën e banuar nga shqiptarët, çështja e Kosovës nuk mund të mos ekzistonte.

Kjo lidhje ka qenë e njohur mirë si nga shqiptarët, ashtu edhe nga fqinjët e tyre dhe nga Fuqitë e Mëdha. Dhe gjithkush, sipas mundësive, në përputhje me synimet gjeostrategjike që ka pasur, ka luajtur lojën e vet politike. Shqiptarët, për arsye të kuptueshme, kanë qenë të *interesuarit e parë që çështja e Kosovës të zgjidhej* sa më shpejt, sa më *drejt dhe në mënyrë përfundimtare*. Në dekadat e fundit, të ndërgjegjshëm për vështirësitë që paraqiste zgjidhja e problemit dhe me besim se demokratizimi, integrimi dhe plotësimi i shumë standardeve në rajon do të kënaqte pjesën më të madhe të kërkesave të tyre, ata nuk kërkuan atë që do të ishte e natyrshme. Shqiptarët, si në Shqipëri dhe në Kosovë, deklaruan shumë herë në mënyrë institucionale, se nuk synonin të bashkonin në një shtet të vetëm Shqipërinë dhe Kosovën ose trevat ku popullsia shqiptare përbën shumicën e popullsisë.⁴ Shqiptarët nuk kërkuan t'u rikuperoheshin dëmet që pësuan në vitin 1913. Ata madje u treguan të gatshëm të sakrifikonin sërish duke toleruar kufijtë që u vunë pa dëshirën dhe kundër interesave të tyre më 1913 apo 1945.⁵ Shqiptarët pranuan

u njoh nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Londrës më 29 korrik 1913. Më gjerësisht shih në botimet e cituara më sipër.

⁴ Shih Axxhanset e ATSH, shtypin shqiptar por edhe mjetet ndërkombëtare të informimit të 15 vjetëve të fundit, madje edhe të periudhës më të hershme.

⁵ Referohu në deklaratat më të fundit, të muajit maj 2006, të presidentit A. Moisiu,

vendosjen dhe respektimin e standardeve në kufijtë ku i gjeti fundshekulli XX, dhe bota mund të monitorojë hapat e tyre në rrugën e duhur dhe seriozitetin e deklaratave të tyre. Në këtë kuadër, shqiptarët e Kosovës kërkuar gjithnjë (shprehur hapur më 1913, 1918, 1919, 1944, 1968, 1974, 1981, 1990 e në vijim) ndonjëherë, si në Konferencën e Bujanit më 1944, duke pasur edhe miratimin e pakicës serbe e malazeze, që Kosova të mos ishte e varur nga Serbia.⁶

Unë nuk besoj se ka ndonjë njohës të çështjes së Kosovës, të historisë së Kosovës, që nuk i ka ditur arsyet përse Kosova duhej të ishte e pavarur. Me një renditje që nuk ka të bëjë gjithnjë me rëndësinë e argumentit, mund të shënohet se, *së pari*, Kosova duhej të ishte e pavarur nga Serbia, sepse ajo *nuk ishte Serbi*. Kosova, edhe pse ka qenë disa herë nën sundimin serb, mbeti gjithnjë një tokë shqiptare. Shqiptarët nuk mbetën kurrë minoritet në Kosovë dhe në prag të shpërbërjes së Federatës Jugosllave përbënin aty mbi 85% të popullsisë kundrejt 8% të serbëve.⁷

Së dyti, Kosova duhej të ishte e pavarur nga Serbia, sepse *gjithnjë ishte dhunuar* nën sundimin e saj. Një informacion i servitur edhe në mënyrë institucionale në Jugosllavi, dëshmon për politikë permanente të spastrimit etnik të organizuar nga shteti serb ose jugosllav në vitet 1878, 1912-1915, 1918-1941, 1945-1966, 1981-1999).⁸ Kjo i ka kushtuar Kosovës vetëm në

kryeministrit S. Berisha dhe ministrit të Punëve të Jashtme B. Mustafaj, si edhe liderëve kryesorë të Kosovës (shih: ATSH, shtypin etj.).

⁶ Referohu deklaratave të presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiut, kryeministrit Agim Çeku dhe liderëve të tjerë kryesorë të Kosovës.

⁷ Shih për konfirmim *Vjetarët statistikorë të KSA të Kosovës (Statistički Godishnjak Srbije)*, 1996 etj., si edhe autorë si Millovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Prishtinë, 1981; Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Prishtinë, 1998; Michel Roux, *Les Albanais en Yougoslavie, minorité nationale, territoire et développement*, Paris, 1992; Jens Reuter, *Die Albaner in Jugoslawien*, "R.Oldenbourg-München", 1982 etj.

⁸ Shih autorët e përmendur si edhe Leo Freundlich, *L'Albaniens Golgotha: Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes*, Vienna, 1913; George Krstiq, *Kolonizacija na Juzhnoj Srbiji*, Sarajevo, 1928; *The truth on Kosovo*, Tiranë, 1992 etj. Sipas M. Obradović, *vep. e përm.*, vetëm në Kosovë në vitet 1918-1941 u vunë nën goditjen e Reformës Agrare rreth 200 000 ha tokë, ose gjysma e tokës bujqësore, nga e cila përfituan kryesisht 14 000 familje kolonësh, serbe e malazeze, të sjellë nga viset e tjera të Jugosllavisë... etj.

harkun kohor të një shekulli, dhjetëra mijë shqiptarëve të vrarë dhe së paku 1 milion të shpërngulur.

Së treti, Kosova duhej të ishte e pavarur, sepse *nën sundimin e Serbisë ajo u pengua të zhvillohej normalisht*. Pasojat e politikës së trajtimit kolonial si para, ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore, e penguan zhvillimin arsimor e kulturor të shqiptarëve, e transformuan strukturën pronësore, atë të punësimit etj., në dëm të shqiptarëve, si edhe e orientuan në drejtime jorentabël ekonominë e Kosovës. Vetëm në vitet 1919-1941, gati 200 mijë ha, ose gjysma e tokës bujqësore në Kosovë, u shpronësua me dhunë në interes të serbëve vendas e veçanërisht të 14 mijë familjeve të kolonëve të ardhur. Kurse pas Luftës së Dytë Botërore, fryt i politikës specifike ishte zbritja e GDP (apo e të ardhurave për banorë) nga raporti 1:2, krahasuar me mesataren jugosllave në vitin 1947, në raportin 1:4 në vitin 1989. Këto pasoja që dëshmojnë për varfërimin e programuar të shqiptarëve gjatë gjithë periudhës, do të mund të riparoheshin vetëm në një Kosovë të pavarur nga Serbia.⁹

Së katërti, Kosova duhej të ishte e pavarur, sepse ajo është ndjerë dhe *ndjehet gjithnjë shqiptare*. Mjafton të kujtohen reagimi masiv i popullsisë së saj në kundërshtim të vendimeve të Kongresit të Berlinit më 1878 për copëtimin e trevave shqiptare, mandej programet kombëtare në periudhën midis dy luftërave botërore, vendimet e Konferencës së Bujanit dhe Lidhjes së Dytë të Prizrenit gjatë Luftës së Dytë Botërore, lëvizja ilegale dhe legale në periudhën 1945-1999, rezistenca e organizuar dhe spontane gjatë gjithë shek. XX kundër sundimit serb etj.¹⁰

⁹ Përveç *Vjetarit statistikor të KSA të Kosovës, Statistički Godishnjak Srbije*, dhe autorëve M. Obradović, M. Roux, N. Malcolm, J. Reuter, shih edhe: Musa Limani, *Politika ekonomike*, Prishtinë, 1994; Marenglen Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave (1945-1990)*, “Mësonjëtorja e Parë”, Tiranë, 2000 etj.

¹⁰ Shih programet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), të Komitetit “MKK” (1818, 1920), Rezolutën e Bujanit (1944), Kuvendi i Kaçanikut (1990) etj., dokumente këto të publikuara prej kohësh. Informacion më i hollësishëm për to gjendet në *Historia e Shqipërisë*, vëll. II dhe III, Tiranë, 1984, si edhe të autorit N. Malcolm, J. Reuter, M. Vickers, K. Frashëri, L. Culaj, L. Rushiti, M. Pirraku, L. Nasi, A. Lalaj, H. Bajrami, M. Verli, S. Basha, I. Hoti, M. Kodra, H. Purellku etj.

Së pesti, Kosova duhej të ishte e pavarur, sepse nën sundimin e Serbisë ka qenë e penguar të integrohej natyrshëm në rajon e të kthehej në një element stabiliteti. Politika që imponoi integrim të dhunshëm, diskriminues dhe vartësi nga Serbia dhe Federata, vendosja e shqiptarëve në pozita inferioriteti etj., janë disa nga provat që tregojnë përse u kthye Kosova në vatër tensioni në rajon.¹¹

Së gjashti, edhe juridikisht, sipas specialistëve, Kosovës nuk i mungojnë argumentet për të qenë e pavarur nga Serbia. Periudha gati njëshekullore, posaçërisht ajo e viteve 1999-2006, konfirmon qëndrimin kolektiv deri institucional, pa përjashtuar edhe sakrificën kolektive të popullsisë shqiptare të Kosovës për t'u vetëqeverisur dhe për të qenë e pavarur plotësisht nga Serbia.¹²

Së shtati, Kosova duhej të ishte e pavarur, sepse asnjë organizëm ndërkombëtar nuk mund të merrte përgjegjësinë t'i mohonte një popullsie shumicë dërmuese në një territor të përcaktuar qartë, të gatshme të votonte të monitoruar vullnetin e vet sa herë t'i kërkohej, të drejtën e vetëvendosjes për të qenë e pavarur. Organizma ndërkombëtare universale, si: *Kombet e Bashkuara, mandej SHBA-ja dhe BE-ja dhe deri aleanca të tilla, si Pakti i Atlantikut Verior (NATO), janë përcaktuar të sigurojnë integritetin, stabilitetin dhe zhvillimin në rajon e më gjerë duke respektuar të drejtat njerëzore, përfshi edhe ato kombëtare dhe vullnetin e shumicës.*¹³

Së teti, politika thellësisht përjashtuese dhe e spastrimit etnik rrënjësor e ndjekur nga Serbia në Kosovë ndaj shqiptarëve në vitet e '90-ta e ktheu në domosdoshmëri luftën e armatosur për pavarësi dhe, njëherazi, u dha argumentin e parë shqiptarëve dhe faktorit ndërkombëtar demokratik për nevojën e shkëputjes së Kosovës nga sundimi i Serbisë dhe për shpalljen e pavarësisë së saj. Shqiptarët nuk mund të jetonin në një shtet që bëri gjenocid mbi ta, në çdo kohë edhe në vitet 1998-1999, kur ky proces agravoi në ekstrem nga S. Millosheviqi dhe pasuesit e tij.

¹¹ Literatura e rekomanduar në referencat e mësipërme është e mjaftueshme për të argumentuar këtë pikë.

¹² Argumentet, përveç të N. Malcolm, gjenden edhe ndër autorë të tjerë, si: M. Vickers, J. Petifer, P. Nushi, G. Zajmi, A. Lalaj, Sh. Maliqi, E. Hasani etj.

¹³ Shih akte ndërkombëtare dhe deklarata të liderëve botërorë në periudhën e fundit.

Ndërsa për shqiptarët çështja e sigurimit të pavarësisë së plotë të Kosovës nga Serbia, përveçse një çështje e drejtë ka qenë një çështje jetike, nuk mund të thuhet se ajo ishte e tillë edhe për kombin serb. Serbët do të duhej të ishin pas shqiptarëve më të interesuarit për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, por ata deri sot, përgjithësisht, nuk kanë llogaritur interesat e shqiptarëve. Në Kosovë jeton vetëm një minoritet serb, por kjo trevë ka qenë konsideruar rajon strategjik që lidhte Serbinë me Maqedoninë e lakmuar gjithnjë, që forconte pozitën serbe në Jugosllavi, që hapte mundësi për të pretenduar me prepotencë një dalje në Adriatikun Jugor përmes Shqipërisë Veriore, mandej rajon i pasur, me vlera për ekonominë e Serbisë, e deri amortizator krizash e trazimesh sociale. Për sa i përket miteve serbe, që e paraqesin Kosovën si “djep të Serbisë”, ato kanë qenë dhe janë vetëm mjet justifikimi, që elitës serbe i ka shërbyer për të mbuluar synimet politike për krijimin e “Serbisë së Madhe”.

Plane e këndvështrime të kësaj natyre i kanë penguar qarqet drejtuese të Serbisë, por, edhe një pjesë të popullsisë serbe, që t’i shikojnë e trajtojnë fqinjët e tyre shqiptarë si partnerë e jo si armiq. Dokumentacioni i publikuar është i mjaftueshëm për të dëshmuar se synimi konstant i Serbisë ka qenë spastrimi etnik në Kosovë, si dhe ricopëtimi, ose dobësimi dhe nënshtrimi i shtetit shqiptar.¹⁴ Për pasojë, shqiptarët në Kosovë asnjëherë nuk u trajtuan normalisht, e aq më pak, nuk u lejuan të vetëvendosin për të ardhmen e tyre. Ata patën humbje të konsiderueshme jetësh njerëzore, pengesa të rritjes së natyrshme demografike, ngecje ekonomike, probleme të mëdha sociale, arsimore, kulturore, trauma shpirtërore kolektive etj.¹⁵

¹⁴ Shih për këtë platforma të shumta, të njohura, si: “Naçertania” e 1844-ës, elaboratet e intelektualëve serbë të “Klubit serb të Kulturës” në vitet ‘30-të, veçanërisht dy elaboratet e viteve 1937 dhe 1944 të akademikut Vasa Çubriloviq, elaboratet e Stevan Moleviqit, diplomatëve, Ivo Andriq e Ivan Vukotiq, Konventën për shpërnguljen të vitit 1938, marrëveshje të tjera, mandej Memorandumin e Akademikëve serbë të vitit 1986, por edhe shumë deklarata e veprime zyrtarësh të lartë si Millosheviqi, apo edhe njerëzish anonimë.

¹⁵ Pasojë e politikës së përmendur janë dhjetëra mijëra të vrarë (nga të cilët mbi 10 mijë të vrarë e të zhdukur vetëm gjatë viteve 1998-1999), qindra mijëra të shpërngulur (nga të cilët rreth 1 milion deri në vitin 1966, qindra mijëra të tjerë deri në vitin 1998 dhe gati 1 milion të tjerë vetëm në pranverën e vitit 1999, të cilët për fat të mirë, me angazhimin e faktorit ndërkombëtar, u rikthyen në Kosovë pas largimit të trupave serbe), një numër i

Një politikë e tillë e zbatuar mbi shqiptarët nuk mund të mos krijonte, sikurse edhe ka ndodhur, një hendek i thellë midis shqiptarëve dhe serbëve.

Por plane e këndvështrime anakronike, ende të pranishme në elitën politike të Serbisë, madje të pranishme jo pak, për shkak të një indoktrinimi shekullor, edhe në një masë të konsiderueshme të popullit serb, binin ndesh me rrjedhat ndërkombëtare të zhvillimit dhe transformimit të gjithanshëm. Produkt i qëndrimit të tejkaluar të Serbisë dhe i dëshirës paranojake për diktat të lidhshpimit të saj ishte shpërbërja e dhunshme e Federatës Jugosllave. Kjo shpërbërje që ndodhi menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë më 1989, nxori probleme të reja për zgjidhje para faktorit ndërkombëtar dhe organizmave të tij, lidhur me rivendosjen e paqes dhe të mirëkuptimit në rajonin e Ballkanit, veçanërisht në territoret e ish-Federatës Jugosllave.

Në këtë kontekst, roli i Paktit të Atlantikut Verior (NATO-s) i krijuar më 4 prill 1949 me pjesëmarrjen fillestare të 12 shteteve (Belgjikë, Kanada, Holandë, Danimarkë, Francë, Islandë, Itali, Luksemburg, Norvegji, Portugali, Britani e Madhe¹⁶ dhe SHBA) ka qenë vendimtar. Shpërbërja e Paktit apo Traktatit të Varshavës¹⁷ më 1991 (krijuar më 14 maj 1955, pas futjes në NATO më 9 maj të Gjermanisë Perëndimore), e la NATO-n pa rivalin tradicional dhe njëherësh bëri të domosdoshëm rivlerësimin strategjik të qëllimeve, natyrës dhe objektivave të Paktit. Ndër synimet e reja bënin pjesë shtrirja gjeografike e NATO-s, madje edhe në territore të ish-vendeve armike, çka filloi me bashkimin e Gjermanisë më 3 tetor 1990, mandej me

pallogaritshëm shqiptarësh të keqtrajtuar, të shpronësuar e të grabitur, dëme dhe shkatërtime masive, përqindje e lartë e analfabetizmit, standard i ulët i jetesës etj.

¹⁶ Më 18 shkurt 1952 u pranuan në NATO Greqia dhe Turqia, më 9 maj 1955, Gjermania Perëndimore, më 30 maj 1982, Spanja, më 12 mars 1999, Çekia, Hungaria, Polonia, më 29 mars 2004, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia, Sllovenia. Në prill 2009, pasi kanë marrë në prill 2008 ftesën për anëtarësim, pritet të pranohen edhe Kroacia dhe Shqipëria. Shih: *Nato-Wikipedia, the free encyclopedia*, në:

<http://en.wikipedia.org/wiki/NATO>, page 9 of 20; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1985, 743.

¹⁷ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, 1107. Në Traktatin e Varshavës bënin pjesë BRSS-ja, Hungaria, Çekosllovakia, Polonia, Bullgaria, Rumania, Shqipëria (deri në vitin 1968) dhe Gjermania Lindore.

ristrukturimin e forcës së armatosur, si edhe me ndërhyrjen për të shmangur katastrofa humanitare, (si ato në Bosnjë e Kosovë) për t'u riorientuar në shekullin e ri edhe kundër terrorizmit ndërkombëtar, në veprime për garantimin e stabilitetit (në Afganistan) në misione trajnuese (në Irak) etj.¹⁸

Operacioni i NATO-s në Kosovë më 24 mars të vitit 1999 ka një prehistori që lidhet me praninë më të hershme të këtij pakti për të shmangur katastrofën humanitare në ish-Jugosllavi dhe destabilizimin e gjithë rajonit të Europës Juglindore, duke respektuar drejtësinë dhe parimet bazë të kartave ndërkombëtare, mbi të cilat funksionon edhe vetë OKB-ja.

Konflikti i ashpër në Bosnjë, si pasojë e ndërhyrjes së Serbisë diktoi ndërhyrjen e parë të NATO-s përmes operacionit të koduar “Sharp Guard” (Mbikëqyrja e Mprehtë) në periudhën qershor 1993-tetor 1996. Përmes tij u zbatua embargoja dhe sanksionet ekonomike ndaj Jugosllavisë, kurse më 28 shkurt 1994 u ndërmor edhe aksioni i parë ushtarak, që përfundoi me rrëzimin e 4 avionëve serbë në Bosnjën Qendrore, të cilët kishin shkelur hapësirën ajrore në zonën e ndaluar për fluturime. Goditjet ajrore të NATO-s veçanërisht në gushtin e vitit 1995 mbi ushtrinë “Sërpska Republikës”, që ndodhën pas masakrës së njohur të Srebrenicës, ndihmuan në përfundimin e konfliktit në Bosnjë dhe në arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit, përmes së cilës nga dhjetori i vitit 1996 deri në dhjetorin e 2004-ës në Bosnjë u vendosën forcat paqeruajtëse.¹⁹

Në kuadër të riorientimit të saj në periudhën pas Luftës së Ftohtë, NATO-ja në vitet 1994-1997 organizoi forume të gjera për bashkëpunim rajonal me fqinjët sikurse ato të “Partneritetit për Paqe” ku Shqipëria u angazhua seriozisht, ishte nga të parat vende që nënshkroi marrëveshjen, madje, ishte vendi i parë nga Evropa Qendrore e Lindore që kërkoi zyrtarisht të hynte në NATO, gjithashtu nismën për “Dialogun Mesdhetar” dhe

¹⁸ Shih: *Nato-Wikipedia ...*, burim i përm., 7, 8, 9, 11- 20; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, 743. Më 1994 ndërhyri në Bosnjë, më 1999 në Kosovë, kurse pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, përparësi ka marrë lufta kundër terrorizmit, në janar 2004 janë dërguar trupa në Afganistan dhe në gusht 2004 në Irak.

¹⁹ Po aty, 6-20.

“Këshillin e Partnershipit Euro-Atlantik”.²⁰ Madje, në vitin 1998 u themelua edhe Këshilli i Përbashkët i Përhershëm NATO-Rusi.²¹

Në këtë mënyrë NATO-ja kishte përgatitur terrenin për të ndërhyrë në Kosovë, ku dhuna mbi shqiptarët, e shkallëzuar pa ndërprerje që nga viti 1988 e veçanërisht pas vitit 1990, kishte çuar në një situatë me pasoja të pallogaritshme. Në 1995 në Dejton, çështja e Kosovës ishte anashkaluar me gjithë përpjekjet vetëmohuese të liderit shqiptar Ibrahim Rugovës, drejtuesit të LDK-së dhe presidentit të Kosovës të zgjedhur me referendum, për ta futur atë në rrugën e zgjidhjes me mjete paqësore. Për të përballuar dhunën serbe e për të mbijetuar, shqiptarëve iu desh pas kësaj të radikalizonin qëndresën e tyre. Shfaqja e UÇK-së në mesin e viteve të ‘90-ta dhe veçanërisht zgjerimi i veprimeve të armatosura në vitin 1998, gjatë të cilit 50 mijë trupa të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë të S. Millosheviqit (10 mijë ushtarë, 30 mijë policë dhe 10 mijë paramilitarë), terrorizonin gjithë popullsinë shqiptare, që mbrohej nga 12-20 mijë luftëtarë të UÇK-së, e agravuan situatën në atë shkallë sa të shfaqej në prag një katastrofë e re e paparë humanitare në Ballkan dhe destabiliteti shpërthyes në rajon të rrezikonte të përfshinte Shqipërinë dhe Maqedoninë.²²

Në rrethanat e rivlerësimit të situatës në të gjithë nivelet e faktorit ndërkombëtar dhe të forcimit të bindjes se UÇK-ja ishte një forcë atdhetare në mbrojtje të popullit të vet, që kërkonte lirinë dhe vetëvendosjen, një palë me peshë në zgjidhjen politike dhe ushtarake, kur strukturat e NATO-s u përgatitën për të ndërhyrë në Kosovë. Objektivat e NATO-s në angazhimin në Kosovë përveç interesit parësor për integrimin sa më shpejt të Ballkanit në Evropë dhe në rastin konkret, të emergjencës, pengimit të një katastrofe humanitare, ishin mbrojtja e të drejtave civile dhe njerëzore të popullsisë, si dhe ndihma për arritjen e një statusi politik për Kosovën.²³

²⁰ Elmaz Leci, *NATO dhe Shqipëria*, Tiranë, 1999, f. 157. Më 8 korrik 1997 Hungaria, Polonia dhe Çekia u ftuan të anëtarësohen në NATO. Anëtarësimi u bë në mars 1999.

²¹ *Nato-Wikipedia*, ..., 6-20.

²² *Po aty*; Shih edhe Sylë Ukshini, *Kosova dhe perëndimi*, Prishtinë, 2001, 45, 48, 86, 105; Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë (Procesi negociator e dokumentet)*, Shtëpia Botuese: “Dukagjini”, Pejë, 2001, 22-23.

²³ *Po aty*.

Kosova nuk ishte për NATO-n vetëm një krizë imediate, por dhe një pasqyrim i kompleksitetit të sfidave të sigurimit të pasluftës së Ftohtë. Konferenca e Rambujesë në fillim të vitit 1999 tregoi se Serbia e S. Millosheviqit ishte e vendosur të shpërfillte rezolutën 1244 të OKB për Kosovën dhe të ndiqte me kokëfortësi, e pozicionuar kundër të gjithëve, kursin e terrorit dhe të dhunës mbi shqiptarët dhe të pastrimit etnik të Kosovës, pavarësisht se veprimet e saj destruktive shkelnin çdo të drejtë humane e kombëtare të një populli të tërë dhe destabilizonin rajonin e Ballkanit.²⁴

Pasi u konsumuan të gjithë instrumentet paqësorë, pasi u kryen të gjitha hapat diplomatikë për të ndalur dorën vrastare të S. Milosheviqit, i cili ndërkohë kishte filluar një spastrim etnik të panjohur për Evropën, duke deportuar rreth 800 mijë njerëz, ose rreth gjysmën e popullsisë së Kosovës, drejt vendeve fqinje dhe duke organizuar një gjueti të vërtetë ndaj atyre që qenë fshehur e strehuar në pyje, më në fund NATO unanimisht vendosi dhe ndërhyri ushtarakisht. Me mirëkuptim të plotë të personaliteteve më të larta të shteteve anëtare të Paktit, presidentit të SHBA-së Bill Clinton, presidentit të Britanisë së Madhe Toni Bler etj., dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Javier Solanës, më 24 mars 1999 në orën 19:00 komandanti i forcave aleate në Europë, gjenerali amerikan Uesli Klark, aktivizoi forcat ajrore për të bombarduar objektivat ushtarake dhe strategjike serbe në Kosovë dhe në Serbi. “Po veprojmë, deklaroi ato ditë presidenti Clinton, - për të ndaluar represionin brutal të Millosheviqit... veprojmë tani sepse në rast se Ballkani bëhet vend vrasjesh brutale dhe shpërnguljesh masive, më pas do të jetë shumë vonë”.²⁵ Mbi 1 000 avionë luftarakë të NATO-s, pas një angazhimi të pashembullt në historinë e Aleancës, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pas 11 javë bombardimesh, pa nevojën e veprimeve tokësore, më 11 qershor 1999 e gjunjësuan makinerinë e luftës së Millosheviqit dhe vullnetin e elitës politike serbe për të vijuar aventurën e përballjes me aleancën më të madhe të të gjitha kohërave.²⁶

²⁴ E. Tahiri, *vep. e përm.*, 9, 21, 34, 41-57.

²⁵ *Nato-Wikipedia* ..., 17-28.

²⁶ *ATSH*, Tiranë, 12 qershor 1999.

Angazhimi i NATO-s për të zgjidhur krizën në Kosovë, tregoi vendosmërinë dhe seriozitetin e paktit për garantimin me çdo kusht të paqes dhe mbrojtjen e vlerave të civilizimit evropian. Në 50-vjetorin e krijimit të saj, NATO-ja tregoi se ishte gjithnjë mburojë e principeve të shpallura. Vendimi për Kosovën mund të shikohet gjithashtu si një kthesë për veprime edhe të pavarura të NATO-s nga OKB-ja, kur këtu vonohen ose pengohen vendime të domosdoshme të shpejta. Operacioni i Forcës së Aleatëve e detyroi Beogradin të pranonte zgjidhjen e ofruar nga OKB-ja, pra largimin e forcave dhe administratës së Serbisë nga Kosova, dhe vënien e saj nën një administrim ndërkombëtar, derisa të vendosej për statusin përfundimtar. Ky operacion shpëtoi Kosovën nga masakrimi masiv dhe spastrimi etnik, shpëtoi dhjetëra mijë jetë njerëzish, duke penguar përsëritjen e gjakderdhjes në përmasat e ndodhura në Bosnjë, gjithashtu solli një transformim, që sa vjen e vihet re më dukshëm, në konceptet e kombit serb për t'u larguar nga mendësia e së kaluarës.²⁷

Njëherësh me veprimet luftarake në Kosovë, NATO-ja instaloi në Shqipëri forcën tokësore (ACE), të quajtur AFOR (Albanien Forc), për të shpërndarë ndihma humanitare për refugjatët e Kosovës. Më pas NATO-ja ndihmoi në krijimin e KFOR-it, një forcë kjo e udhëhequr nga NATO-ja me mandatin e OKB-së, që kreu misionin ushtarak në Kosovë, duke krijuar qetësi për veprimtarinë e UNMIK, administratën ndërkombëtare të Kosovës.²⁸ Hapja e diskutimeve për statusin e Kosovës në vitin 2006-2007, ku pozicionet e palëve ishin krejt të kundërta, gjithsesi përbënte hapin e parë të duhur që sillte jo vetëm për shqiptarët, por edhe për serbët, shansin e madh për raporte të reja, të cilat sjellin, pa dyshim, për të dy palët dhe për gjithë rajonin, stabilitet, zhvillim e integritet. Analistë të shumtë kanë pranuar se duke servirur për shqiptarët e Kosovës një lidhje varësie nga Serbia, as në Kosovë, as në Serbi, rrjedhimisht as në rajon, nuk ka qenë e mundur të prodhohet mjaftueshëm demokraci, paqe dhe prosperitet. Përcaktimi i Malit të Zi për t'u shkëputur nga Serbia, i hoqi çdo dilemë faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës në mënyrën e duhur.

²⁷Nato-Wikipedia ..., 15-28.

²⁸Po aty.

Në Serbi elita politike nuk mund të mos e kuptonte se dy shtete shqiptare në Ballkan nuk prishnin ekuilibrat dhe nuk dhunonin paqen e sigurinë rajonale. Në Serbi e kanë ditur gjithashtu se me format e vjetra të mbajtjes nën kontroll, Kosova nuk do të kishte vlera ekonomike për Serbinë, madje në atë situatë do të pengohej edhe çlirimi i energjive mendore dhe ekonomike të serbëve për ngritjen e gjithanshme dhe integrimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. Në Serbi e kanë pasur të qartë se Shqipëria dhe Kosova, do të ishin të interesuara për zbatimin e marrëveshjes së asocim-stabilizimit, orientim ky i garantuar edhe nga interesat e Bashkimit Evropian dhe të SHBA-së. Në Serbi nuk mund të mos e kenë parë se shqiptarët i vlerësojnë dhe i dëshirojnë lidhjet e hapura dhe miqësore në rajon, sepse vetëm 60 milionë banorët e tij dhe jo gjithsej 6-7 milionë shqiptarët e veçuar, e bëjnë rajonin, pra edhe trevat shqiptare, pjesëtare të një tregu me përmasa të pranueshme për investime serioze perëndimore.

Pas ndërhyrjes së NATO-s u shtua numri i serbëve, që e kuptuan se politikës së vjetër i kishte kaluar koha, se BE-ja dhe SHBA-ja, duan që në Ballkan të kalohet nga faza e stabilitetit në atë të zhvillimit rajonal.²⁹ Pikërisht në këtë kuadër, shumë vende të OKB-së, BE-së, SHBA-së dhe NATO-s, e vlerësuan zgjidhjen e çështjes së sovranitetit dhe zhvillimit të shqiptarëve në Kosovë, pa dyshim edhe të statusit dhe të standardeve të duhura për pakicën serbe atje. Rajoni si i tërë mund të ketë sukses për t'u drejtuar në BE vetëm nëse lidhet mbi bazën e respektimit të të drejtave të natyrshme të gjithkujt, qoftë të kombeve, qoftë të pakicave dhe të shanseve të të gjithëve për zhvillim ekonomik, kulturor etj. Në Serbi u shtuan ata që kërkonin të guxohej për të hedhur hapat në drejtimin e duhur, se Pavarësia e Kosovës dhe e Malit të Zi (e vendosur kjo e dyta me referendumin e datës 21.05.2006), do t'i vendosnin palët në raporte partneriteti dhe lidhjesh normale. Vetëm kështu, jo vetëm të dy shtetet shqiptare, por edhe Serbia do të kalonin nga faza e nevojave për ndihma tek investimet normale, nga papunësia e ngecja ekonomike në zhvillim ekonomik, në kapërcimin e armiqësive të së kaluarës. Pavarësia e Kosovës do të shërbente si një faktor madhor stabiliteti edhe për faktin se vetë

²⁹ Shih për këtë edhe intervistën e profesorit amerikan John Lamp - ekspert për problemet e Evropës Lindore dhe Ballkanit, botuar në gazetën "ABC", dt. 29.04.2006.

Kosova, e cila ka nevojë për zhvillim, për investime për përparimin, do të siguronte stabilitetin e vet të brendshëm për qytetarët e vet. Asnjë projekt tjetër veç pavarësisë nuk mund të sillte aty paqe e stabilitet, por edhe në botën shqiptare në Ballkan, rrjedhimisht edhe në rajon.

Në Serbi, ende nuk është gjendur zgjidhja e përshtatshme që të afrohet me atë që kërkuan me këmbëngulje shqiptarët, krijimin e *shtetit apo Republikës së pavarur të Kosovës* pa lidhje speciale me Serbinë. Pozicioni i tillë nuk ka sjellë vonesë në evropianizimin e Serbisë e të Ballkanit dhe ka krijuar mundësi për instrumentalizimin e ballkanasve. Çështja e Kosovës e krijuar dikur kundër interesave të shqiptarëve solli për ta një tragjedi gati shekullore, por edhe destabilitet në rajon, prandaj ajo mund të *përfundonte vetëm me pavarësinë e Kosovës*”.

Shqiptarët besuan gjithnjë se BE-ja dhe SHBA-ja i kishin të gjitha mundësitë që të bindnin të gjithë ata që kundërshtonin njohjen e pavarësisë së Kosovës, se pavarësia e saj ishte hap konstruktiv në interes të gjithë botës së re demokratike. Shqiptarët gjithashtu shpresuan se me zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës do të pajtoheshin të gjitha vendet demokratike dhe opinioni publik demokratik botëror. Pas 9 vjetësh më 17 shkurt 2008, duke pasur për bazë paketën me propozimet e të dërguarit të OKB-së, Marti Ahtisarit, Kosova shpalli pavarësinë, duke garantuar faktorin ndërkombëtar se Republika më e re e Evropës, do të respektojë kartat ndërkombëtare, do të jetë demokratike dhe faktor stabiliteti në rajon.³⁰ Kjo shpallje, pavarësisht nga kompleksiteti i vështirësive, është njohur për një kohë të shkurtër nga dhjetëra shtete, ndër të cilët bëjnë pjesë SHBA-ja dhe demokracitë perëndimore më të fuqishme. Kështu çështja e Kosovës e krijuar dikur kundër interesave të shqiptarëve, e cila prodhoi për shqiptarët një tragjedi shekullore, por edhe një destabilitet në rajon, me angazhimin konstruktiv të faktorit ndërkombëtar dhe me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të NATO-s në mbështetje të popullit shqiptar të Kosovës dhe bijve të tij, luftëtarëve të UÇK-së, u zgjidh në një mënyrë të pranueshme, duke çuar kështu përpara zgjidhjen e çështjes shqiptare dhe krijimin e frymës së marrëdhënieve konstruktive dhe demokratike midis kombeve të Ballkanit. Mirënjohja e shqiptarëve ndaj

³⁰ATSH, Tiranë, 17 shkurt 2008.

NATO-s dhe devotshmëria për të shërbyer në strukturat e saj për të mirën e paqes dhe të stabilitetit ndërkombëtar është provuar. Republika e Shqipërisë është anëtare e Paktit nga prilli i vitit 2009,³¹ duke hapur rrugën që në një të ardhme të afërt aty të bëjë pjesë edhe Republika e Kosovës. Në këtë mënyrë shqiptarët, perëndimorë në prirjet e tyre, më në fund do ta kapërcejnë atë periudhë zigzagesh do të shfrytëzojnë mundësinë historike për t'u integruar në mënyrë institucionale në strukturat Euro-Atlantike, jo vetëm ushtarake, por edhe ekonomike, kulturore, arsimore etj.

Në përfundim të kësaj kumtese do të theksoja dy prej mesazheve që përcjell politika e NATO-s ndaj shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë e më gjerë. *Së pari*, mund të thuhet, pa dyshim, se roli i shqiptarëve dhe pozita strategjike e viseve të tyre në Ballkan është rivlerësuar në periudhën pas Luftës së Ftohtë, dhe, është tepër e rëndësishme, ndoshta e rëndësishme si asnjëherë më parë, që nga shekulli XV, apo siç njihet që nga koha e Skënderbeut. *Së dyti*, mbështetja e NATO-s për shqiptarët dëshmon se aspektet nacionale ose fetare, nuk ndikojnë në veprimtarinë e aleancës, që udhëhiqet nga parimet e sigurisë, të ruajtjes së paqes në botë, të demokracisë, drejtësisë dhe zhvillimit. Edhe pse me zanafillë më të hershme çështja e Kosovës, siç dihet, u shfaq e plotë në vitin 1913, për shkak të vendimeve të Fuqive të Mëdha të marra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Shqiptarët nuk ishin në gjendje të pengonin më 1913 krijimin e çështjes së Kosovës dhe as patën rast, fuqi e aleatë, ose mirëkuptim rajonal e ndërkombëtar, që ta korrigjonin apo ta zgjidhnin atë më vonë në mënyrë të drejtë, por vendimi i marrë krijoi një precedent të rrezikshëm për stabilitetin në rajon deri në ditët tona.

Shqiptarët, për arsye të kuptueshme, kanë qenë të interesuarit e parë që çështja e Kosovës të zgjidhej sa më shpejt, sa më drejt dhe në mënyrë përfundimtare. Kosova duhej të ishte e pavarur nga Serbia, sepse ajo nuk ishte Serbi, sepse gjithnjë ishte dhunuar nën sundimin e saj, sepse nën sundimin e Serbisë ajo u pengua të zhvillohej normalisht dhe sepse është ndjerë dhe ndjehet gjithnjë shqiptare. Asnjë organizëm ndërkombëtar nuk mund të merrte përgjegjësinë t'i mohonte një popullsie shumicë dërrmuese në një

³¹Po aty, Tiranë, 18 prill 2008. (Ndërkohë që kjo kumtesë vonoi të botohej, Shqipëria, më 4 prill 2009, sikurse pritej, u bë anëtare e NATO-s).

territor të përcaktuar qartë, të drejtën e vetëvendosjes për të qenë e pavarur. Politika thellësisht përjashtuese dhe e spastrimit etnik rrënjësor e ndjekur nga Serbia në Kosovë ndaj shqiptarëve në vitet e '90-ta e ktheu në domosdoshmëri luftën e armatosur për pavarësi dhe, njëherazi, u dha argumentin e parë shqiptarëve dhe faktorit ndërkombëtar demokratik për nevojën e shkëputjes së Kosovës nga sundimi i Serbisë dhe për shpalljen e pavarësisë së saj.

Më 1995 në Dejton, çështja e Kosovës ishte anashkaluar me gjithë përpjekjet vetëmohuese të liderit shqiptar Ibrahim Rugovës, drejtuesit të LDK-së për ta futur atë në rrugën e zgjidhjes me mjete paqësore. Për të përballuar dhunën serbe e për të mbijetuar, shqiptarëve iu desh pas kësaj të radikalizonin qëndresën e tyre. Në rrethanat e rivlerësimit të situatës në të gjithë nivelet e faktorit ndërkombëtar dhe të forcimit të bindjes së UÇK-së, por një palë me peshë në zgjidhjen politike dhe ushtarake, në strukturat e NATO-s u përgatitën për të ndërhyrë në Kosovë. Kosova nuk ishte për NATO-n vetëm një krizë imediate, por dhe një pasqyrim i kompleksitetit të sfidave të sigurimit të pasluftës së Ftohtë. Angazhimi i NATO-s për të zgjidhur krizën në Kosovë, tregoi vendosmërinë dhe seriozitetin e paktit për garantimin me çdo kusht të paqes dhe mbrojtjen e vlerave të civilizimit evropian. Operacioni i Forcës së Aleatëve e detyroi Beogradin të pranonte zgjidhjen e ofruar nga OKB-ja, pra largimin e forcave dhe administratës së Serbisë nga Kosova dhe vënien e saj nën një administrim ndërkombëtar derisa të vendosej për statusin përfundimtar. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë. Kështu çështja e Kosovës, u zgjidh në një mënyrë të pranueshme duke çuar kështu përpara zgjidhjen e çështjes shqiptare dhe krijimin e frymës së marrëdhënieve konstruktive dhe demokratike midis kombeve të Ballkanit.